



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-23-0034

Në ankesën e

Paditësi/Ankuesi

Z M, Kraljevë, Republika e Serbisë, i përfaqësuar nga **Projekti për ndihmë juridike**, Graqanicë.

kundër

E paditura

NSH Tefik Çanga(në likuidim) e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përberë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Agron Hoxhaj gjyqtarë, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër Aktvendimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-1703 të datës 22 dhjetor 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 11 janar 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e paditësit është e bazuar.**
- 2. Anulohet Aktvendimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-1703 i datës 22 dhjetor 2022.**
- 3. Lënda kthehet në rishqyrtim në shkallën e I-rë të DHPGJS-së, tek gjyqtari përkatës.**
- 4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me datë 11 shtator 2013, paditësi për mes postës e dorëzoi në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit GJI110-0606 të datës 30 korrik 2013, me të cilin ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensim pronësor nga NSH KDI "Tefik Çanga"(në likuidim), në shumë të pa përcaktuar, me arsyetimin se paditësi ka dorëzuar kërkesën me datë 07 mars 2006, që është para afatit kohor, dhe pa filluar ende procedura e likuidimit, ndërsa pas fillimit të procedurës së likuidimit në afatin e dhënë deri me 06 nëntor 2006, nuk ka dorëzuar kërkesën, andaj bazuar në nenin 35.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, kërkesa e pakohshme, duhet të hedhet poshtë si e pavlefshme.

Në ankesë paditësi ka pohuar se Vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit nuk është i bazuar në ligj, pasi që kur ai është informuar me datë 07.03.2006, e ka dorëzuar kërkesën në Zyrën e BE në Beograd. Tutje ai pohon se nuk kishte marrë as një njoftim nga AKM-ja për mundësin e paraqitjes së kërkesave në procedurën e likuidimit. Në ankesë paditësi kishte kërkuar që të lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore, pasi që nuk ka mundësi të paguaj taksën, për shkak të gjendjes jo të mirë materiale. Në ankesë ai kishte kërkuar nga gjykata, që komunikimi të kryhet për mes Avokatit G M, i angazhuar në Projektin për ndihë juridike, Graqanicë.

Me datë 27 maj 2021, shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktvendimin, C-IV-13-1703, bazuar në nenin 469, paragrafi 2 të LPK-së, e refuzon kërkesën e paditësit që të lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore, me arsyetimin se paditësi nuk ka sjellë asnjë dëshmi në mbështetje të kërkesës.

Ky Aktvendim i është dërguar paditësit në adresën e dhënë në ankesë, mirëpo nuk është e qartë nga posta nëse paditësi e ka marrë Aktvendimin, ndërsa plikojat e dërgesës kthehet prapa, dhe në pliko është një raport i postës me datë 16.08.2021, si datë e dorëzimit, dhe një nënshkrim i Zyrtarit të postës, mirëpo mungon fletë kthesa e nënshkruar nga paditësi.

Aktvendimi për refuzimin e kërkesës për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore, nuk ishte dërguar tek Avokati G M, i angazhuar në Projektin për ndihë juridike, Graqanicë,

siç kishte kërkuar paditësi në ankesë, që komunikimi i gjykatës të bëhej për mes këtij Avokati.

Pas këtij veprimi procedural, në bazë të Shënimit Zyrtar të referentes së gjykatës, Aktvendimi për refuzimin e kërkesës për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore, është publikuar edhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës, nga data 09 dhjetor 2022 e deri me 19 dhjetor 2022.

Me datë 22 dhjetor 2022, shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktvendimin C-IV-13-1703, ankesën e paditësit e konsideron si të tërhequr. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se Aktvendimi për refuzimin e kërkesës për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore, i është dërguar paditësit në adresën e dhënë në ankesë, mirëpo nuk është kthyer fletë kthesa në gjykatë, për kundër faktit se sipas shpërndarësit të postës thuhet se ky Aktvendim i është dorëzuar të njëjtit. Tutje shkalla e I-rë konstaton se meqenëse Vërejtja e hartuar nga gjykata nuk ka mundur ti dorëzohet në adresën e dhënë, atëherë ky Aktvendim është publikuar edhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës, nga data 09 dhjetor 2022 e deri me 19 dhjetor 2022, mirëpo nuk është paguar taksa gjyqësore.

Ky Aktvendim dorëzohet në Projektin për ndihmë juridike në Graçanicë, me datë 16 janar 2023.

Me datë 24 janar 2023, paditësi për mes postës e dërgoi në DHPGJS një ankesë kundër Aktvendimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-1703 të datës 22 dhjetor 2022, për të gjitha bazat ankimore dhe ka kërkuar që të prishet Aktvendimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rigjykim. Paditësi në ankesë thekson se ky Aktvendim ka shkelur dispozitat procedurale, është i pakuptimtë, dhe nuk sqaron arsyet pse ankesa konsiderohet e tërhequr. Tutje paditësi pohon se nuk janë respektuar procedurat sipas nenit 253.3 të LPK-së. Paditësi pohon se zyrtarja e gjykatës në bazë të nenit 5.3 të UA për pagesën e taksës gjyqësore, nr.1/2017, është dashtë ti dërgon paditësit një herë Vërejtjen për taksë, duke caktuar edhe shumën që duhet të paguaj, dhe nëse nuk paguhet taksa, Gjyqtari pastaj duhet të lëshon Urdhrin që të paguhet taksa gjyqësore, dhe pastaj nëse nuk paguhet taksa ankesa është dashtë të konsiderohet e tërhequr. Tutje paditësi pohon se ai në ankesë ka

kërkuar që komunikimi i gjykatës të bëhet me Avokatin e Projektit për ndihmë juridike falas, e që në këtë rast nuk është vepruar. Ai pohon se asnjë Vërejtje për taksë nuk i dërguar Projektit për ndihmë juridike falas, në Graqanicë, i cili ishte i autorizuar në bazë të ankesës ti pranoj shkresat e dërguara të gjykatës për paditësin.

Me datë 20 mars 2023, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës së paditësit. Në këtë parashtresë AKP-ja i kundërshton pretendimet ankimore të paditësit duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj, dhe e mbështet Aktvendimin e ankimuar të Kolegjit të Specializuar, duke e konsideruar si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Tutje AKP-ja pohon se ankuesi nuk ka paraqitur fakte dhe prova materiale dhe as bazën juridike as për padinë dhe as për ankesën, andaj ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktvendimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e paditësit është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktvendimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së nuk është i saktë në rezultat, andaj ai duhet të anulohet dhe lënda të kthehet në rishqyrtim.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në ankesën e tij të dorëzuar në shkallën e I-rë të DHPGJS-së, kishte kërkuar që të lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore, pasi që ai ka pohuar se nuk ka mundësi të paguaj taksën, për shkak të gjendjes jo të mirë materiale.

Në ankesë ai kishte kërkuar nga gjykata, që komunikimi të kryhet për mes Avokatit G M, i angazhuar në Projektin për ndihmë juridike, Graqanicë.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se shkalla e I-rë e DHPGJS-së, me datë 27 maj 2021, me Aktvendimin, C-IV-13-1703, duke u bazuar ne nenin 469, paragrafi 2 të LPK-së, e refuzon kërkesën e paditësit që të lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore, me arsyetimin se paditësi nuk ka sjellë asnjë dëshmi në mbështetje të kërkesës.

Në këtë lëndë Kolegji i Apelit konsideron se nuk janë ndërmarrë nga gjykata hapat e duhur dhe sipas radhës, lidhur me pagesën e taksës gjyqësore për ankesën e dorëzuar në shkallën e I-rë të DHPGJS-së.

Së pari në këtë lëndë nuk ishte përgatitur dhe as nuk i është dorëzuar paditësit as një vërejtje për taksë gjyqësore, dhe as nuk është caktuar nga gjykata se sa duhej paguar paditësi për ankesën e tij të dorëzuar në shkallën e I-rë. Nuk kishte ndonjë Urdhër as për paditësin dhe as për Avokatin e tij që të përcaktojë dhe specifikoj shumën e kërkesës.

Së dyti në këtë lëndë komunikimi i gjykatës, nuk është kryer siç ka kërkuar paditësi në ankesën e tij.

Së treti, nuk ka prova në dosje, nëse paditësi e ka pranuar Aktvendimin e shkallës së I-rë me të cilin atij i është refuzuar kërkesa që të lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore.

Në dosje ekziston plikojë e dërgesës e kthyer prapa. Në plikojë është një raport i postës me datë 16.08.2021, si datë e dorëzimit, dhe një nënshkrim i Zyrtarit të postës, mirëpo mungon në dosje fletëkthesa e nënshkruar nga paditësi.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se Aktvendimi për refuzimin e kërkesës për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore, nuk ishte dërguar tek Avokati G M, i angazhuar në Projektin për ndihë juridike, Graqanicë, siç kishte kërkuar paditësi në ankesë.

Pas këtij veprimi procedural, në bazë të Shënimit Zyrtar të referentes së gjykatës, Aktvendimi për refuzimin e kërkesës për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore, është publikuar edhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës, nga data 09 dhjetor 2022 e deri me 19 dhjetor 2022.

Mund të konstatohet se nuk ka dëshmi në lëndë se paditësi e ka pranuar Aktvendimin për refuzimin e kërkesës që të lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore, dhe afishimi i këtij Aktvendimi në tabelën e shpalljeve të gjykatës nuk e mbulon dorëzimin e rregullt dhe ligjor të këtij Aktvendimi, pasi që ky Aktvendim nuk është dorëzuar në adresën e të autorizuarit të paditësit, siç ai kishte kërkuar me ankesë.

Prandaj Aktvendimi i ankimuar i shkallës së I-rë të DHPGJS-së, me të cilin konsiderohet ankesa si e tërhequr, në bazë të arsyeve të cekura, nuk ka mbështetje ligjore.

Andaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit konstaton se rezultati i dhënë me Aktvendimin e ankimuar, nuk mund të mbështet nga Kolegji i Apelit, pasi që nuk është i drejt dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të arsyeve të cekura, ankesa e paditësit aprovohet si e bazuar, anulohet Aktvendimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, dhe lënda kthehet në rishqyrtim që të shqyrtohet, dhe që ti jepet rast paditësit ta paguaj taksën gjyqësore për ankesën e tij në shkallën e I-rë, e pastaj të merret me aspektet tjera të pranueshmërisë së ankesës.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore:

Ankuesi nuk është obliguar të paguaj taksën gjyqësore për procedurën ankimore, për shkak se tek Ankuesi nuk është dorëzuar nga gjykata vërejtja për taksë gjyqësore për shkak të kërkesës së papërcaktuar me ankesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit, me datë 11 janar 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtari kryesues _____